



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 52, datë 27.07.2022

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“STRUKTURA BANIMI INDIVIDUALE 1-2 KAT MBI TOKË DHE 1 KAT NËNTOKË ME MUR RRETHUES”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesve Z. Ilirjan Celibashi, Znj. Ardjana Mediu, Shoqëria “Beauty International” sh.p.k, Z. Astrit Kamberi, Z. Dritan Shehu, Z. Artan Nito, Znj. Lindita Nito, Znj. Sonila Xukthi, Z. Arlind Nito dhe Z. Kledion Nito, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Struktura banimi individuale 1-2 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë me mur rrethues”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me zhvillues Z. Ilirjan Celibashi, Znj. Ardjana Mediu, Shoqëria “Beauty International” sh.p.k, Z. Astrit Kamberi, Z. Dritan Shehu, Z. Artan Nito, Znj. Lindita Nito, Znj. Sonila Xukthi, Z. Arlind Nito dhe Z. Kledion Nito.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 01/03 / 2025